

E DIELA IV E KRESHMEVE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Përsëmbëllta të Triodit më Tingëllin Tërthor IV:

PAS O TU PARADHOKSU THAVMATOS

Atë Shën Joan o ashkëti, zgjedhën e Zotit Jesu, përmi supet me gas e ngre, dhe me Kryqn' e shtrin përdhe, kryelartin Satan të zi, dhe me banorë, çdo shkretëtir' e mbush, me manastire, murgë dhe ashkëtinj. Lum' ti o Oshënar, o lavdi e klllogjërve, pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë ne, që të shpëtohem.

Atë Shën Joan o ashkëti, për të fituar në qjell, lumërin' e përjetshime, në varrin i gjallë hyn, frikë s' ke prej demonëve, dhe kërcënimet, s' ua përfill aspak, dhe faqebardhë, del me të falurat; o trim i shpirteve, kryetar i murgëve, pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë ne, që të shpëtohem.

Atë Shën Joan i Atërve, si ashkëti të Jesujt, të nderojm' e të falemi, shkove shkretëtirave, si në dasmë me ngazëllim, edhe u-bëre, prijës i murgëve, pra të thërresim, me brohori dhe nder: Lum' ti o Shën Joan, o lavdi e klllogjërve, pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë ne, që të shpëtohem.

LAVDI, T.T.I. Atë Oshënar, e dëgjove zërin e Zotit, e neverite botën, pasurinë dhe lavdinë, dhe kështu u thërrisnje të gjithëve. Dojeni Perëndinë, dhe do të gjeni hir të përjetmë, kur të këthehet me lavdi, me të gjithë Shenjtorët; me lutjet e tyre o Krisht, ruaji dhe shpëtoji shpirtet tona.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T. II: Engjëllin përmi dhe, Joantin ashkëtinë, që mbolli shkretëtirën, dhe rriti dhënt' e Krishtit, kremtojeni me brohori.

Tania e Tingëllit, Përlëshorja e Tingëllit, pastaj:

PERLESHORJA E SHEN JOANIT, T. T. IV.
PAS TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si rrëke, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtim dhe psherëtim, gjer në qint herë pemë mblodhe për çdo mundim; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove botën me çdo çudi, Joan i Shenjtë Atë dhe Oshënar, lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

Pastaj këndohet Hyjlindësorja e Tingëllit Tërthor IV:

TANI. Ti që linde për ne prej Virgjëreshës, dhe durove kryqësimin o i Mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje, dhe u-ngjalle si Perëndi, mos i harro ata që gatove me dorën tënde, po tregoje njeridashjen si mëshirëplot, prit-e Nënë Hyjlindëse, që nërmjeton për ne, dhe shpëtoje o Shpëtimtar, popullin e dëshpëruar.

SHKURTORJA, T. IV
PAS EPEFANIS SIMERON

Më të lart' o Shën Joan, Zoti të ngriti, si një yll të qiellit, që tërë botën e ndriçon, me predikimin e fjalëve, i lavdëruar Mësonjësi i Kishëve.

SHTEPIA

U-tregove tempulli i Perëndisë, o Atë, i stolisur me virtuta të larta, predikove besën, shpresën dhe dashurinë, dhe rrotje mi dhenë si një Engjëll, dhe u-lartësove

me përunjësinë, me urtësinë dhe me trimërinë. Përandaj trashëgove lumëritë qjellore, o Atë Shën Joan Oshënar, i lavdëruar Mësonjës i Kishëve.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Katërtë të Kreshmëve, kujtojmë Shën Joantin, Atin tonë Oshënar, Shkronjësin e Shkallës.

Me nërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Pastaj Zbritësoret: "Ja gojën e çel tani." Pas Dërgimësoreve Ngjallësore, këndohen:

DERGIMESORET, T. II.
PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Dëgjove Zotin Krisht o Shenjt, e neverite botën, shkove në shkretëtirë, dhe e lërove me lote, mbolle kudo virtuta, Mësonjës i besnikëve, shkrove Shkallën e Fjalëve për shpëtim, edhe për pendim të çdo mëkatari, predikator i Kishëve, lëçitës i Ungjillit.

O Krijetar i botëve. . . . (Shiko të Dielën e Orthodoxisë)

LAVDERIMET

Këndohen Vargëzimet e Tingëllit, edhe Lavdia e ditës:

LAVDI, T. I. Ejani të punojmë në vreshtën mistike, dhe le të sjellim pemë pendimi, jo me të ngrëna dhe me të pira, po me lutje dhe me agjërimë, dyke lëruar virtuta; se Zoti i pëlqen këto vepra, dhe i çpërblen me denarin, dhe na i lan shpirtet nga detyrat e mëkatit, si i vetëmi mëshirëplot.

TANI. E përmibekuar je, o Hyj lindëse Virgjëreshë.

Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Tingëllit, e Shën Joanit, edhe Shkurtorja "Përlufteshës Gjenerale."

Zoti do t'i japë forcë popullit të vetë.

Lavdërojeni Zotin, o bij Perëndie.

Këndimi prej Letrës së Palit për Hebrejtë.

Vëllezër, Perëndia, kur iu-betua Abrahamit, meqë-nëqë nukë kishte asnjë më të math, u-betua mi veten e tij, dyke thënë: "Shigurisht me bekime do të bekonj, dhe me shtime do të shtonj." Dhe kështu ay bëri zëmër të gjerë, dhe e fitoj zotimin. Se njerëzit betohen mi emrin e një më të madhi, dhe beja është një shiguri, dhe u jep funt kundrështimeve të tyre. Për këtë gjë, Perëndia, dyke dashur t'u tregonjë trashëgimtarëve zotimin, që bëri një vendim të patundur, ua shiguroj me be. Pra nga këto dy gjëra të patundura, nga Perëndia dhe nga beja e tij, kemi një ngushëllim të fortë dhe një shpresë të shëndoshë ne, të cilët kemi përikur nënë hien e tij. Dhe këtë e kemi si një ankër të shigurtë dhe të patundur, të shpirtit, e cila hyn përtej kurtinës në Shenjtëroren, ku hyri më parë Jesuj për ne, kur u-bë kryepriфт për jetë pas urdhërit të Melkishedekut.

UNJILLI PAS MARKUT

Më atë kohë, një njeri iu-afrua Jesujt, edhe i ra më gjunjë, dhe i thoshte: "Mësonjës, të kam prurë tim-bir, i cili ka një demon të pagojë; dhe kur e zë, e shkunt, edhe shkumbëzohet, edhe kërcëllen dhëmbët, edhe

thahet; edhe u thashë dishepujve të tu që tja nxjerin, po nukë muntne." Dhe Jesuj u-përgjeq, edhe i tha: "O brez i pabesë, gjer kur do të jam me ju? Gjer ku do tju duronj? Silleni këtu." Edhe ia suallnë; dhe demoni, kur e pa Jesunë, menjëherë e shqeu djalin, edhe ra përdhe, edhe rugullizej i shkumbëzuar. Dhe Jesuj e pyeti t' atin: "Sa kohë ka që i ngjan kjo gjë?" Edhe i-ati u-përgjeq. "Qëkur ishte i vogël; dhe shumë herë e ka hedhur në zjarr edhe në ujë që ta humbasë; po nëqoftëse e ke në dorë, ndih-na, kij mëshirë për ne." Edhe Jesuj i foli kështu: "Nëqoftëse ke besë, të gjitha janë të mundura për njerinë, i cili beson." Edhe menjëherë i-ati i djalit thirri me lot, edhe i tha: "O Zot, besonj; ndihmoje pabesinë time." Dhe Jesuj, kur pa që po mblidhej gjindja, e qërtoj demonin e paudhë, dhe i tha: "Demon i pagojë dhe i shurdhër, unë të urdhëronj: Dil prej tij, edhe mos i hyr brënda më." Edhe demoni, passi bërtiti, dhe e shqeu shumë, doli, dhe djali u-bë si i vdekur, aqë sa shumë thoshin që vdiq. Edhe Jesuj e zuri për dore, dhe e çoj, edhe ay u-ngrit. Edhe kur hyri në shtëpi, dishepujtë e pyesnin mënjanë: "Përse nukë muntmë ta nxirnim ne?" Edhe Jesuj u-përgjeq: "Ky soj nukë munt të nxirret me tjetër mënyrë veçse me lutje dhe me agjërime." Dhe duallnë s'andejmi, dhe shkonin nëpër Galilenë; dhe nukë deshte që ta dinte njeri. Se i mësonte dishepujtë, dhe u thoshte: "Se i Biri i njeriut përipet në duart' e njerësve, dhe do ta vrasin; dhe passi të vrasin, do të ngjallet më ditën e tretë."

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit.